



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije / Ministry of Economy

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Ekonomisë shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Inspektor për pajisje nën presion
Klasa e pozitës	Profesional 1
Koeficienti/Paga	8
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	21/03/2023
Afati për aplikim	12/04/2023 - 19/04/2023
Institucioni	Ministria e Ekonomisë
Departamenti	Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm
Divizioni	Inspektorati i Energjise
Vendi i punës	Prishtinë
Nr. i Referencës	RN00011207
Kodi	RPC0004848



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Kryen mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore në lëmin e pajisjeve nën presion.
2. Mbanë evidencën e inspektimeve , avarive dhe regjistrin e pajisjeve nën presion që janë shfrytëzuar.
3. Urdhëron ndalimin e shfrytëzimit të pajisjeve dhe instalimeve nën presion deri sa të eliminohen lëshimet dhe të metat e konstatuara.
4. Urdhëron heqjen nga përdorimi të pajisjeve dhe instalimeve nën presion në rastet kur ato nuk i plotësojnë kërkesat themelore të sigurisë teknike.
5. Në rast të inspektimit harton raportet e inspektimit me të cilin vërteton sa a janë plotësuar kërkesat themelore të sigurisë për pajisjet dhe instalimet nën presion .
6. Shqipton masa administrative apo gjoha për kundërvajtje të përcaktuara sipas ligjit për Pajisje nën Presion.
7. Harton planin e punës dhe sipas nevojës kryen dhe punë tjera.
8. Sipas nevojë merr pjesë në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore.
9. Kryen detyra tjera të caktuara nga Udhëheqësi i Njësisë së Inspektimit të Energjisë

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilin aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë – Inxhinier i diplomuar i Makinerisë
- **Kualifikime të posaçme formale:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase.
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy (2) përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës .



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 26/04/2023, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- 08/05/2023 (data e përafërt), ora 10, Ministria e Ekonomisë Adresa: Sheshi Zahir Pajaziti nr.36, Prishtinë

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

- Aftësi komunikuese dhe organizative, si ndërtimi dhe përkrahja e punës në ekipe , motivimi dhe promovimi i metodave bashkëkohore të punës
- Aftësi për të ndërmarr iniciative dhe të punoj në mënyrë të pavarur;
- Njohuria me Direktivat dhe Rregulloret e BE-së në lëmin e shkencave teknike, ambientit dhe sigurisë në punë;
- Aftësi për të punuar me kompjuter OS MS Windows, MS Office (Word, Excel, Power Point, Outlook)
- Aftësi të punon në nivelim më të lartë të konfidencialitetit dhe transparencës .

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist



10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

